

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 5-2018

PAPUNËSIA DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Elena Desku

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

PAPUNËSIA DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Shkalla Bachelor

Elena Desku

Maj, 2018

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2014-2015

Elena Desku

PAPUNËSIA DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Mentor: Sema Kazazi

Maj, 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Papunësia dhe Zhvillimi ekonomik

Studenti : Elena Desku

Profesori udhëheqës : Sema Kazazi

Universiteti: University of Business and Technology

Drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Prishtinë, 2018

Qëllimi kryesor i këtij punimi është studimi poashtu analiza e papunësisë dhe zhvillimit ekonomik në shoqëri. Në hyrje janë të paraqitura termet dhe kuptimi i tyre, pastaj ndërlidhja që këto nocione kanë me njëra tjetrën.

Papunësia konsiderohet si një fenomen social për shkak të efekteve që ka në strukturën sociale të shoqërisë. Një ndër qështjet më të rëndësishme sociale ka qenë gjithmonë punësimi , për shkak që e afekton zhvillimin ekonomik të shoqërisë dhe stabilitetin shoqëror. Punësimi rezulton në prodhim, ndërsa prodhimi krijon të ardhura dhe të ardhurat rezultojnë në kërkesë për produkte, kështu duke krijuar një zinxhir. Padyshim që papunësia është një ndër indikatorët kryesor të ekonomisë

Zhvillimi ekonomik mund të nënkuptojë rritje në kompleksitet, ose dhe progres drejt arritjes së një qëllimi të caktuar. Mjeti më i rëndësishëm për ta zvogëluar varfërinë dhe për të përmirësuar kualitetin e jetesës është rritja ekonomike. Rritja gjeneron prosperitet dhe mundësi të shumëta. Zhvillimi ekonomik qon drejtë përparimit të njerëzimit , me të cilin promovohet rritja ekonomike. Në vazhdim këto dy terme janë më gjerësisht të zhvilluara.

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Fillimisht do të doja të falenderoja profesoreshën Sema Kazazi, për ndihmën e dhënë dhe këshillat për përgatitjen e temës të diplomës. Poashtu të gjithë stafin e UBT-së për mësimëdhënien e palodhshme në këto vite që do të na shërbejë për të ardhmen përgjatë karrieres sonë.

Padyshim për fund por jo më të parëndësishmit , një falenderim i vecantë shkon për familjen time, prindërit e mi pa të cilët asnjë nga këto nuk do të ishte e mundur. Shpresoj që një ditë do të jem në gjendje të ua shperblejë të gjithë mundin, sakrificën dhe mbështetjen e pashterrshme që më keni dhënë përgjatë këtyre viteve.

Elena Desku

Maj /2018

Prishtinë

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E TABELAVE.....	IV
LISTA E FIGURAVE	IV
1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
2.1 Papunësia.....	4
2.2 Teoritë e papunësisë.....	5
2.3 Ndikimi i papunësisë në shoqëri	6
2.4 Zhvillimi ekonomik.....	7
2.5 Faktorët që ndikojnë në rritje ekonomike.....	9
2.6 Lidhja midis papunësisë dhe zhvillimit ekonomik.....	13
2.7 Ligji i Okunit	18
4. METODOLOGJIA.....	26
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	27
5.1 Niveli i zhvillimit tek shtetet Ballkanike	28
5.2 Sfida e zhvillimit -problemi.....	31
6. DISKUTIME DHE KONKLUZIONE.....	33
7. REFERENCAT.....	36

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Faktoret qe shkaktojne papunesine	21
Tabela 2 Te dhenat e eksporteve dhe importeve ne neto/kg.....	29

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Aktiviteti ne grup tek të punësuarit dhe të papunësuarit	6
Figura 2 Ligji i Okunit.....	20
Figura 3 Trendet dhe Zhvillimet nder vite tek shtetet fqinje	28
Figura 4 Eksporti, importi dhe bilanci tregtar i Kosoves me Shqiperine 2008-2014.....	30

1. HYRJE

Papunësia është një fenomen negativ multidimensional që ndikon në cdo shoqëri njerëzore. Referohet si një defekt ekonomik që e afekton strukturën e komunitetit duke pasqyruar një mungesë në balancim të aktivitetit ekonomik. Konsiderohet si një fenomen social për shkak të efekteve që ka në strukturën sociale të shoqërisë. Norma e papunësisë llogaritet duke kalkuluar numrin e individëve të papunë dhe duke e pjestuar atë me individët që bëjnë pjesë në fuqinë punëtore. Dimensioni social dhe ekonomik i papunësisë rrisin kompleksitetin dhe imponojnë miratimin e analizave të gjëra për të kuptuar shkaqet dhe pasojat e një fenomeni të tillë. Përgjatë periudhës së recesionit , ekonomia zakonisht përjeton një normë të lartë të papunësisë, dhe sipas një raporti të Labour Organization më shumë se 200 milion njerëz ose 6% i fuqisë punëtore në botë kanë qenë të papunë në vitin 2012. Papunësia ende mbetet një debat i konsiderueshëm teorik lidhur me shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet për papunësinë. . Studimet kanë treguar që papunësia e tejzgjatur sjell vështirësi, probleme dhe humbje të shumëta të të ardhurave. Papunësia nuk është vetëm një vështirësi financiare, por papunësia sjell në vete dhe izolimin social, duke e bërë më të pakët kontaktin me të afërmit dhe shoqërinë. Pra vështirësitë të cilat i sjellë papunësia janë të shumëta. Zhvillimi i teknologjisë ndikon në mënyrën e punësimit. Dhe përshkak të këtyre ndryshimeve të shumëta strukturore një kualitet thelbësor është intelegjenca/njohuritë. Rëndësia e intelegjencës vë një theks të rëndësishëm në kualifikim dhe edukim. Dhe si pasojë e mungesës së këtyre njohurive, njerëzit përballen me vështirësi të shumëta për gjetjen e një pune në marketin e sotëm. Mundësia për uljen e numrin e papunësisë është kur qeveria ndërhyr duke përdorur metodat e veta. Pra qeveria

mundohet që ta zbus numrin e të papunë në dy mënyra, me anë të politikës monetare dhe asaj fiskale. Politika monetare kontrollohet nga Banka Federale e SHBA've, si stimulim për krijimin e vendeve të punës Banka Fedarale ndihmon në këto dy mënyra ; zvogëlimi i normës së interesit në mënyrë që të jetë më lirë për bizneset dhe bankat për të marr para hua. Pra qëllimi është që të i shtyjn bankat të investojnë në mënyrë që bizneset të zgjerohen, pra duke stimuluar zhvillimin dhe punësimin. Norma e ulët e interesit i shtyn njerëzit të harxhojnë më shumë para. Me anë të politikës fiskale qeveria ndërhyr duke i : heqjen e taksave për bizneset dhe individët në mënyrë që të stimulojnë dhe rrisin zhvillimin, rritja e shpenzimeve të qeverisë, punësimi i punëtorëve për krijimin e sistemeve të transitit etj. (*Jahoda, 1982*)

Paralelisht zhvillimi ekonomik është një objektiv kryesor i politikës monetare poashtu dhe asaj fiskale. Zhvillimi ekonomik është një proces i vazhdueshem i rritjes së kapacitetit të prodhimit , për rritje të të ardhurave nacionale poashtu dhe nivelit te kapitalit. Zakonisht në përgjithësi, zhvillimi ekonomik është fokusi i qeverive federale, shtetërore dhe lokale për të përmirësuar standardin tonë të jetesës përmes krijimit të vendeve të punës, mbështetjes së inovacionit dhe ideve të reja, krijimit të pasurisë së lartë dhe krijimit të një sistemi sa më të mirë cilësisë së jetës. Rritja ekonomike është kryesisht për investimin në kapital dhe forcën punëtore poashtu përmirësimin e produktivitetit të këtyre faktorëve të prodhimit përgjatë procesit të inovacionit dhe absorbimit tekologjik. Faktorët e ndryshëm që ndikojnë në zhvillim/rritje ekonomike janë të shumtë, dhe secili nga ta ka rëndësinë e vet. Disa nga këta faktorë janë :

- investimi ne infrastrukturë,
- investimi në edukim,

- investimi në agrikulturë

Prioriteti kryesor i regullit ekonomik ka tendencë në zhvillim ekonomik kështu duke reflektuar pozitivisht në reduktimin e nivelit të papunësisë. Puna është faktor kryesor i prodhimit , dhe mos përdorimi i këtij faktori qon drejt një humbje të madhe ekonomike. *(Al Habbes dhe Abu Rumman , 2012).*

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Papunësia

Me rritjen e interesimit për papunësinë si rrjedhojë erdhën hetime intenzive për shkaqet e papunësisë nga studiues dhe ekonomistë të shumtë. Njëri ndër ta ishte John Maynard Keynes, një ekonomist britanik idetë e të cilit patën një impakt të madh në shoqëri dhe teoritë e makroekonomisë. Teoria Keynesian u zhvillua përgjatë viteve 1930 për ta kuptuar më mirë periudhën e depresionit të madh apo të njohur më mirë si periudha e Great Depression. Ku në librin e tij "The General theory of Employment, Interest and Money" ai shpalosi të gjitha teoritë e tij, ku dhe kritikoi shumë ekonomistët klasik por dhe mbrojtë fuqishëm teorinë e tij personale. Teoria Keynes, bazohet tek faktorët e prodhimit (eficienca e punës, të mirat e kapitalit, teknologjia , oferta e punës etj) mbesin të pandryshueshme gjatë përcaktimit të nivelit të punësimit. Sipas tij niveli i punësimit varet nga të ardhurat kombëtare dhe prodhimi. Kështu nëse do ketë rritje në të ardhurat kombëtare atëherë do kishte rritje në nivelin e punësimit dhe e kundërta. Sipas tij, rritja e kërkesës efektive agregate do të rriste nivelin e punësimit dhe anasjelltas dhe rënia e kërkesës totale efektive do të çonte në papunësi . Me rritjen e të ardhurave kombëtare rritet edhe niveli i konsumit, por rritja e nivelit të konsumit është relativisht e ulët në krahasim me rritjen e të ardhurave kombëtare. Norma e ulët e konsumit çon në një rënie të kërkesës efektive. Prandaj, hendeku midis të ardhurave dhe nivelit të konsumit duhet të reduktohet duke rritur numrin e mundësive për investime. Rrjedhimisht, rritet edhe kërkesa efektive, e cila ndihmon më tej në reduktimin e papunësisë dhe në sjelljen e kushteve të plota të punësimit.

2.2 Teoritë e papunësisë

Papunësia Keynesian, e njohur edhe si papunësia e kërkesës me deficiencë, ndodh kur nuk ka kërkesë të mjaftueshme agregate në ekonomi për të siguruar vende pune për këdo që dëshiron të punojë. Kërkesa për shumicën e mallrave dhe shërbimeve bie, nevojitet më pak prodhim dhe rrjedhimisht nevojiten më pak punëtorë, pagat janë të dobëta dhe nuk janë në nivelin e duhur për të përmbushur nivelin e ekuilibrit.

Por një teori më e thjeshtë e papunësisë është kur kërkesa dhe oferta për punë nuk takohen në një pikë të përbashkët, apo ndryshe quajtur ekuilibrium. Pra pika e ekuilibriumit kërkon që numri i njerëzve që janë të interesuar për punë të jenë në balanc me numrin e njerëzve që po kërkojnë punë. Me fjalë të thjeshta papunësia është numri i njerëzëve në forcën punëtore që duan të punojnë por nuk kanë një punë dhe që kalkulohet : numri i individeve të papunë duke e pjestuar me individët që bëjnë pjesë në fuqinë punëtore. Ndërsa forca punëtore përfshin njerëzit që janë të aftë për punë , duke i përjashtuar ata që janë në pension, të paafte , dhe në gjendje për të punuar mirëpo për momentin nuk janë në kërkim të ndonjë pozite. (Hall, 1979)

Një ndër qështjet më të rëndësishme sociale ka qenë gjithmonë punësimi , për shkak që e afekton zhvillimin ekonomik të shoqërisë dhe stabilitetin shoqëror. Punësimi rezulton në prodhim, ndërsa prodhimi krijon të ardhura dhe të ardhurat rezultojnë në kërkesë për produkte, kështu duke krijuar një zinxhir. Padyshim që papunësia është një ndër indikatorët kryesor të ekonomisë. Problemi për shumicën e atyre që punojnë është që edhe atë punë që e kanë, nuk mund të sigurojnë një të ardhme sadopak të mire për veten dhe fëmijët, dhe ndodh që shumicën e kohës këta njerëz punojnë në kushte jo të sigurta. Në ekonominë globale , bota e punës është duke evoluar shumë shpejtë.

Ndryshimet demografike, teknologjike, dhe faktorë të ndryshem i japin formë tjetër pamjes së punësimit përreth botës. Vendet të cilat mund të adaptohen shpejtë në këto ndryshime drastike, atëherë këto vende janë ato që mund të arrijn përfitime të mëdha në rritjen e produktivitetit dhe standardit jetësor.

2.3 Ndikimi i papunësisë në shoqëri

Puna ndikon se si njerëzit e shohin veten dhe si ata janë në raport me të tjerët. Eshhtë faktor që ndikon se si shoqëria e përballon vendimmarrjen si tërësi- në grup. Natyra e punës luan një rol kryesor, punët që i japin shtysë, respektojnë të drejtat, vleresojnë mundin, kanë efekt pozitiv në identitetin dhe rrjetin social poashtu dhe drejtësinë.




Figura 1 Aktiviteti ne grup tek të punësuarit dhe të papunësuarit .

(WDR,2013)

Në grafën e mësipërm, shihet se si aktiviteti në grup, me dhe papunë ndikon në shoqëri. Njerëzit që janë të papunë, marrin pjesë më pak në shoqëri dhe aktivitete të ndryshme, pra janë më të demoralizuar dhe më pak aktiv, në nivelin 0. Ndërsa ata që kanë një punë janë më aktiv dhe kanë më shumë motiv, siç shihet në nivelin mbi 0. (WDR, 2013)

2.4 Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik do të thotë rritje absolute në madhësinë e kapitalit apo prodhimit vjetor pavarësisht madhësisë së popullatës. Kuptimet janë të shumëta, mund të nënkuptojë rritje në kompleksitet, ose dhe progres drejt arritjes së një qëllimi të caktuar. Në përgjithësi investimi i referohet të gjithë aktiviteteve ekonomike që përfshijnë përdorimin e resurseve për prodhim të të mirave dhe shërbimeve. (Robbins, 1968)

Të gjitha modelet e rritjes apo zhvillimit ekonomik fokusohen tek kapitali si një nga dy parametrat kryesor në përcaktimin e shkallës së zhvillimit ekonomik. Ekziston një marrëveshje e përgjithshme, që procesi i rritjes/zhvillimit ekonomik dhe investimi/formimi i kapitali janë të lidhura ngushtë. Që të dyja palët, ekonomistët neoklasik dhe marksistët kanë vënë theksin kryesor tek akumulimi i kapitalit si një makinë e zhvillimit ekonomik. Një përdorim i rëndësishëm i kapitalit është rritja e prodhimit të kapitalit të të mirave intensive. Konsumimi i këtyre të mirave e ngrit rritjen e të ardhurave nëpërmjet kapitalit. Sipas bankës botërore (1989), rritja e GDPsë është e lartë tek ato vende të cilat kanë një raport relativisht të lartë investimesh. (Anwer dhe Sampath, 1999)

Mjeti më i rëndësishëm për ta zvogëluar varfërinë dhe për të përmirësuar kualitetin e jetesës është rritja ekonomike. Rritja gjeneron prosperitet dhe mundësi të shumëta. Rritja e fortë dhe stabile ndikon në përmirësim të kushteve që prindërit ua

ofrojnë fëmijëve për një jetesë dhe shkollim sa më të mirë. Zhvillimi ekonomik qon drejtë përparimit të njerëzimit , me të cilin promovohet rritja ekonomike.

Në 50 vitet e fundit nga studimet e shumëta është bërë e ditur që rritja ekonomike është mënyra më efektive për ti nxjerr njerëzit nga skajshmëria duke i shtyr ata në objektiva më të gjëra për një jetë sa më të mirë.

Lidhja në mes të rritjes dhe punësimit nuk është thjeshtë tek sasia e punëve të krijuara. Rëndësia qëndron dhe tek lloji i punëve të krijuara. Rritja ekonomike nuk është thjeshtë e lidhur vetëm me largimin nga varfëria. Rritja ekonomike është një provë e qartë pozitive midis lidhjes së rritjes ekonomike dhe zhvillimit njerëzor-human. Dmth rritja ekonomike nuk është krejtësisht vetëm për materializëm, laureate nobel Amartya Sen, e ka përshkruar rritjen ekonomike si qështje kyqe për zgjerimin e lirive që njerëzit vleresojnë. Këto liri janë ngushtë të lidhura me përmirësimin e standardeve jetësore në përgjithësi, sikur: mundësi më të mëdha për njerëzit të bëhen të shëndetshëm, të ushqehen më mirë dhe të jetojnë sa më gjatë.

Rritja e fortë ekonomike dhe mundësitë për punësim, i stimulojnë familjet që të investojnë në edukim- pra duke i derguar fëmijët për shkollim. Kjo gjë qon drejt krijimit dhe rritjes së grupeve të lidereve. Është më se e vërtetë që të ardhurat sa më të larta që të jenë aq më i mirë është kualiteti jetësor; në shëndetesi si dhe në edukim.

Nuk ka rregulla universale unike. Rritja e qëndrueshme ekonomike varet nga funksionet kyqe që duhet të përmbushen përgjatë kohës. Akumulimi i kapitalit fizik dhe human, efienca në alokimin e resurseve , adaptimi i teknologjisë, dhe shpërndarja e benefiteve të rritjes.

Rritja ekonomike është kryesisht për investimin në kapital dhe forcën punëtore poashtu përmirësimin e produktivitetit të këtyre faktorëve të prodhimit përgjatë procesit të inovacionit dhe absorbimit teknologjik. Faktorët e ndryshëm që ndikojnë në zhvillim/rritje ekonomike janë të shumtë, dhe secili nga ta ka rëndësin e vet.

2.5 Faktorët që ndikojnë në rritje ekonomike

Më poshtë janë të paraqitur disa nga faktorët kryesor që ndikojnë në rritje ekonomike.

- Investimi në infrastrukturë është veqanërisht i rëndësishëm për vendet që janë më pak të zhvilluara, pasi që infrastruktura e bën të mundur për prodhuesit përdorimin e teknologjisë moderne dhe kur prodhuesit njoftohen me këtë teknologji moderne zgjerimi i infrastrukturës stimulon aktivitete produktive.

-Investimi në edukim dhe trajnim prodhon një fuqi punëtore më të shkathët dhe më produktive. Investimi në kapitalin njerëzor e rrit vlerën e kohës së prindërëve dhe koston e rritjes së fëmijëve. Ngritja e koston së rritjes së fëmijëve e ulë pjellorinë dhe rrit kursimin e dëshiruar për person, e cila nga ana e vet rrit normën e rritjes së kapitalit (Barro, 1991)

-Investimi në studimet agrikulurore e përmirësojnë dhe lehtësojnë shpërndarjen e rezultateve të hulumtimeve shkencore që gjithashtu rrisin prodhimin.

Pra siq e shohim, investimi luan një rol mjaftë të madh dhe të rëndësishëm nëse përdoret në mënyrë efektive për të rritur prodhimin, në të kundërtën nëse investimi bëhet në mënyrë jo efektive atëherë rezultojnë një shkallë e ulët e rritjes së prodhimit.

Rritja në të ardhura ofron nxitje për më shumë kursime dhe nga ana tjetër më shumë investime, duke shkaktuar rritje të GDP'se. Me rritjen e GDP'se qeveria shpenzon më shumë në infrastrukture , gjë që e rrit produktivitetin marxhinal të kapitalit dhe punës në sektorët privat duke inkurajuar më shumë investime. Pra sa më shumë investime aq më shumë kapacitet të prodhimit , më shumë mundësi për punë dhe rroga të larta, të gjitha këto duke rezultuar në të ardhura më të larta duke shkaktuar GDP-në. (Anwer dhe Sampath, 1999)

Pyetja më me vend, për regjionet me të ardhura të ulëta është se si ta ngrisin nivelin e investimit dhe rritjes së produktivitetit. Faktorët që ndikojn në këtë ngritje janë:

→Kapitali fizik- zhvillimi kërkon investim në kapitalin fizik: bimët, makineritë, lënda e parë e papërpunuar etj, të gjitha këto janë kryesore për prodhim. Investimi në të gjitha shkallët kërkon kapital financiar. Cdo vend që ka arritur rritje dhe zhvillim të qëndrueshem, ka menaxhuar poashtu rritjen në nivelet e investimeve vendore dhe të jashtme si pjesë apo përqindje e GDP'së. Teknologjia poashtu bën pjesë në të mirat e kapitalit, pasi që makineritë ndihmojnë në mbështetjen e vendit në rritjen apo krijimin e shkallës së teknologjisë të avancuar. Por natyrisht kualiteti i investimeve ka më shumë rëndësi sesa kuantiteti.

→Kapitali njerëzor- investimi në edukim dhe njohuri është po aq i rëndësishëm sa investimet në makineritë dhe të mbjellat për arritjen e zhvillimit. Shpenzimet e këtij lloji të investimit janë që të dyja direkte dhe indirekte. Direkte sepse shpenzon për pajisjet shkollore dhe librat, indirekte sepse kosto oportune e pagave të humbura për arsimim. Përmirësimi i këtyre, së bashku me ngritjen e kthimit në arsim ka gjasë të rrisë investimet arsimore.

Nje gamë e gjërë e shkathtësive për punë nevojiten për të katalizuar dhe për të mbështetur zhvillimin, duke përfshirë edukimin në të gjitha nivelet nga shkolla fillore e deri tek universiteti, dhe duke përfshirë trajnimet e ndryshme duke u bazuar tek “ duke u mësuar – duke bërë”. Por fatkeqësisht në vendet me zhvillim të ngadalët, përmirësimet nuk janë dhe aq te dukshme dhe në pah.

→Ambienti biznesor, duhet të ketë mbrojtëse që sigurojnë kthimin e investimeve të mbledhur nga investitorët. Jo stabiliteti politik, korrupsioni dhe krimet , të gjitha këto e kërcënojnë apo janë rrezik potencial ne kthim, dhe i bëjnë investimet më pak atraktive në këtë mënyrë duke dëmtuar rritjen-zhvillimin. Studimet e ndryshme të fundit, i identifikojnë kostot e ligjit të kontratave, si ato që kanë impaktin kryesor negativ në profitabilitetin biznesor.

→Konkurrenca e tregut -Konkurrenca siguron ose bën të mundur që konsumatorët të marrin apo përfitojnë më shumë te mira për një kosto më të ulët sesa në monopol. Eshtë më se e drejtë që bizneset të hyjnë dhe dalin nga tregu me një lehtësi. Në bazë te këtij regulli, firmat dhe industritë mund ta ngrisin produktivitetin, që në këmbim sjell zhvillim më jetëgjatë.

→Stabiliteti makroekonomik- Investitorët marrin vendime duke u bazur në shkallën e fitimit që ata presin të marrin në rrezikim të projekteve investuese. Sa më i madh rreziku aq më e lartë shkalla e kërkuar e kthimit. Një ambiennt stabil makroekonomik është vendimtar në reduktimin e rrezikut të lidhur me investimet.

→Gatishmëria për tregti dhe investim -Asnjë vend nuk ka krijuar stabilitet ekonomik pa u integruar suksesshëm në marketin global. Ekzistojne dy aspekte – integrimi në të mirat e marketeve dhe integrimi në marketet inpute, kryesisht në kapitalin

financiar. Kjo e mundëson zhvillimin e vendit, bën lehtësimin e transferit teknologjik duke rrit konkurrencën dhe përfitimin e të mirave tek konsumatorët.

→Niveli i rritur i produktivitetit të agrikultures- Vendet me të ardhura të ulëta, janë vendet tipike të cilat kanë sektor të gjërë të agrikultures. Ky produktivitet ka efekt të fortë në zvogëlimin e varfërisë për shkak të numrit të lartë të fuqisë punëtore të përfshirë në këtë sektor- agrikulture. Adaptimi dhe zhvillimi i teknologjisë dhe përmirësimi i marketeve agrikulturore për fara, të mbjella, për fertilizim, dhe prodhimet agrikulturore e ndihmon këtë proces.

Një strategji për zhvillim ekonomik bazohet në analize rigorozë ekonomike nga rrethanat dhe mundësitë e vendit. (DFID, 2017)

Padyshim që zhvillimi ekonomik është objektiva kryesore e çdo vendi/shteti në botë. Cdo vit ndihma të ndryshme ndahen, investime të ndryshme ndërmerren, rregulla dhe plane të ndryshme elaborohen për arritjen e këtij qëllimi – rritjes ekonomike apo sadopak që ti afrohen përmbushjes së këtij qëllimi. Por si i identifikojmë rezultatet e këtyre përpjekjeve? Si mund ta masim zhvillimin që një vend ka kaluar, ose prej cilit nivel në cilin ka kaluar? Pra si e matim rritjen/zhvillimin ekonomik?

Kjo qështje nuk është e lehtë për tu zgjidhur. Cdo njeri në mendjen e tij ka një përceptim se çka është zhvillimi ekonomik. Në përgjithësi në mendjen tonë ky zhvillim na parafytyrohet një shoqëri ku të gjithë kanë kushte të jetesës normale, të veshur dhe të ushqyer në mënyrë të mirë dhe posedim i disa të mirave materiale për jetesë. Mendojm për një shoqëri të pavarur dhe të lirë në shprehjen e opinionit të tyre dhe pa diskriminime gjinore, një shoqëri me stabilitet familjar, me nivel të krimeve të ulëta dhe me një stabilitet politik.

Historikisht matjes të zhvillimit ekonomik iu kushtohet vëmendje tek të ardhurat e kapitalit, shpërndarja e të ardhurave , si dhe indikatorëve tjerë të ndryshëm të zhvillimit siq janë zhvillimi i sektorit agrikor dhe kompozimi i importit dhe eksportit etj. (Lucas, 1988)

Rritja ekonomike përfshin një gamë të gjërë informacionesh, duke përfshirë shëndetësinë, edukimin , barazinë gjinore, aksesin në demokraci etj. Mirëpo forma më e përdorur për matjen e zhvillimit apo rritjes ekonomike është Human Development Index e prodhuar nga United Nations Development Programme. Ku tre matësit më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik janë:

-niveli i pasurisë brenda shtetit duke u matur nga GDP-ja

-shëndeti duke u matur nga jetegjatesia mesatare,

-edukimi duke u matur nga përqindja e popullatës për një moshe të caktuar dhe niveli i shkollimit. Variablat kombinohen duke i radhitur prej 0 (që konsiderohet niveli më i ulët i zhvillimit) dhe 1shi (niveli më i lartë i zhvillimit). (*What is development and how it can be measured*).

2.6 Lidhja midis papunësisë dhe zhvillimit ekonomik

Papunësia është një fenomen që ndikon negativisht në çdo shoqëri njerëzore në përmasa dhe drejtime të ndryshme. Referohet si një defekt ekonomik që e afekton strukturën e komunitetit. Papunësia shfaq një jo balancim ekonomik, ndërsa paralelisht rritja ekonomike është një qëllim apo synim i çdo vendi për ekonominë fiskale dhe

monetare. Sa më i lartë që të jetë niveli i papunësisë, aq më pak mundësi ka për rritjen/zhvillimin ekonomik të vendit.

Përfaqësues të shteteve të ndryshme dhe top ekonomistët e të gjitha vendeve të botës, shumë herë e kanë parashtruar pyetjen dhe janë përpjekur për të ardhur ë konkludim se çfarë mase politike duhet ndërmarrë në mënyrë që të luftohet papunësia? Pasiqë papunësia është burim i një depresioni ekonomik, krimi dhe përçarjeje të shoqërisë, andaj masa të ndryshme duhet të merren për të. Ne bazë të shkollave ekonomike të ndryshme qëllimi kryesor është rritja e punësimit. Pra punësimi mund të gjenerohet duke e nxitur rritjen/zhvillimin ekonomik. (Marth, 2015)

Gjetjet duket se mbështesin hipotezën se rritja ekonomike siguron një shtysë të punësimit, por punësimi mund të marrë një moment të vetin, qoftë pozitiv apo negativ. Me fjalë të tjera, punësimi i dobët gjeneron punësim të dobët, dhe anasjelltas. Për shembull, në fillim të një rimëkëmbimi ekonomik, prodhimi fillon të rritet, duke i dhënë një shtysë punësimit. Megjithatë, rritja e punësimit mund të vonojë, veçanërisht në fund të një recesioni, sepse punësimi i dobët çon në më shumë të njëjtën gjë. Ky koncept është i vështirë për t'u shpjeguar, por është pak si një atlet i kualifikuar i elitës, i cili plagos veten: kur lëndimi shërohet, ai mbetet i dobët dhe është i ngadalshëm në rimëkëmbjen e formës së lartë për shkak të dëmtimit që ai vuajti dhe taksës fizike që mori. Ngjashëm, rritja ekonomike duhet të jetë e qëndrueshme që të ketë një ndikim në punësim: sapo të fillojë punësimi për të reaguar ndaj rritjes ekonomike, ajo zhvillohet nga vrulli i vet. (Desnoyers, 2011)

Shumica e ekspertëve janë pothuajse të mendimit të njejet që çelësi i rimëkëmbjes ekonomike apo zhvillimit ekonomik është ulja e nivelit të papunësisë. Pra a ka kuptim që

celesi i rritjes ekonomike ndikon ne ulje te papunesise? Nese qendron ky fakt atehere vijm ne konkludim qe ndryshimet ne papunesi jane nje faktor i rendesishem i zhvillimit ekonomik real. (Shostak , 2010)

Papunësia është një problem i madh që e afekton zhvillimin ekonomik negativisht.

Me poshte jane te paraqitura efektet qe ka :

- 1) Shfrytëzimi i punës; për shkak të shkallës së papunësisë punëtorët shfrytëzohen. Pra ata duhet të pranojnë paga të ulëta dhe të punojnë në kushte jo të favorshme.
- 2) Mosmarrëveshjet industriale: Mosmarrëveshjet industriale lindin për shkak të papunësisë. Ka efekte negative në marrëdhëniet punëdhënës-punonjës. Për shkak të mosmarrëveshjeve industriale, papunësia rritet.
- 3) Paqëndrueshmëria politike :Ka paqëndrueshmëri politike në vend për shkak të papunësisë. Personat e papunë angazhohen në aktivitete destruktive. Ata e konsiderojnë qeverinë, të pavlefshme. Zhvillimi ekonomik bëhet i vështirë në kushtet e paqëndrueshmërisë politike.
- 4) Problemet sociale: Shumë të meta shoqërore si pandershmëria, bixhozi dhe imoraliteti etj. Lindin për shkak të papunësisë. Keto rrezikojnë situatën e rendit dhe ligjit në vend, ku shkaktohn ndërprerje sociale në shoqëri.
- 5) Rritja e varfërisë: Nën situatën e papunësisë një burrë nuk ka burim të ardhurash. Papunësia shkakton varfëri. Barra e borxhit rritet. Problemet ekonomike rriten.
- 6) Humbja e burimeve njerëzore: Për shkak të papunësisë, burimet njerëzore shkojnë në mbeturina. Asnjë përdorim konstruktiv i fuqisë punëtore nuk është bërë. Nëse burimet njerëzore përdoren siç duhet, rritja ekonomike e vendit do të rritet. (Mehta)

Në shumë vende qeveria duhet t'i paguajë të papunëve disa përfitime. Sa më i madh të jetë numri i të papunëve apo sa më gjatë që ata të jenë pa punë, aq më shumë para qeveria duhet të derdhë jashtë. Prandaj, jo vetëm që vendi duhet të merret me të ardhurat e humbura dhe me rënien e prodhimit, por edhe me kosto shtesë.

Rritja e taksave dhe pasiguria në lidhje me punën e tyre mund të ndikojnë në fuqinë e shpenzimeve të njerëzve që punojnë dhe gjithashtu ata mund të fillojnë të shpenzojnë më pak se më parë duke ndikuar kështu ekonominë dhe shoqërinë në mënyrë negative.

Me normat e rritjes së papunësisë, ndikojnë dukshëm faktorët e tjerë të ekonomisë, siç janë: të ardhurat për person, shpenzimet shëndetësore, cilësia e kujdesit shëndetësor, standardi i largimit dhe varfëria.

Të gjitha këto ndikojnë jo vetëm në ekonomi por në të gjithë sistemet dhe shoqërinë në përgjithësi. Këtu janë disa aspekte të ndikimit të papunësisë në shoqërinë tonë : Papunësia ndikon jo vetëm vetë personin, por edhe familjen e tij / saj dhe në një kohë të gjatë shoqërinë ku jeton.

Papunësia sjell me të dëshpërim, pakënaqësi dhe ankth. Ajo detyron njerëzit të jetojnë jetën e tyre në një mënyrë që ata nuk dëshirojnë - Jetëgjatësia është e prekur negativisht.

Jetëgjatësia është lehtësia me të cilën njerëzit që jetojnë në një kohë / vend janë në gjendje të kënaqin nevojat / dëshirat e tyre. Këtu janë aspektet kryesore:

1). Shëndeti mendor: ndikimi në vetëbesim; ndjenja e te qenit të pavlerë, depresioni dhe pafuqia. Me humbjen e të ardhurave atëherë nervoza vije me të, dhe të papunet zhvillojnë

sjellje negative ne lidhje me gjerat e ndryshme ne jete dhe ndihen sikur arsyeja e cdo gjeje ka humbur. Emocione te shpeshta mund te jene ; niveli i ulet i vetebesimit dhe ndjenja i te qenit te refuzuar dhe te pashprese.

2). Semundjet; papunesia ne pergjithesi mund ta rrise ne menyre drastike problemet shendetesore tek individet. Tensioni ne shtepi: mosmarreveshjet dhe argumentet ne shtepi qe mund ta ngrisin tensionin dhe qe ndikojne ne ngritje te numrit te divorceve etj.

3).Qeshtjet politike: humbja e besimit ne administrate dhe ne qeveri mund te qoj drejte jo stabilitetit politik. Tensioni ne rritjen e taksave: papunesia sjell paknaqesi dhe ndjenja te frustrimit tek taksapaguesit.

4) Pasiguria në mesin e të punësuarve: Papunësia mbizotëruese dhe gjendja e vështirë e të papunëve dhe familjeve të tyre mund të krijojnë frikë dhe pasiguri edhe në njerëzit e punësuar aktualisht.

5) Krimi dhe dhuna: do ketë rritje në shkallën e krimeve. Poashtu dhe rastet vetëvrasëse do të ketë rritje të numrit të përpjekjeve për vetëvrasje.

6).Papunësia sjell një zvogëlim në bashkëveprimet sociale me njerëzit e tjerë duke përfshirë këtu dhe miqët e ngushtë.

7).Papunësia sjell më shumë se sa thjesht 'asnjë punë'. Gjithashtu sjell me vete turpin që personi duhet të mbajë. Askush nuk i pëlqen të quhet i papunë.

8). Boshllëqet e punësimit: Për të komplikuar më tej situatën sa më gjatë individi është jashtë punës, aq më e vështirë bëhet për të gjetur një. Punëdhënësit gjejnë kohën që keta persona që kane qene te papune si nje aspekt negativ. Askush nuk dëshiron të punësojë

një person i cili ka qenë jashtë punës për një kohë edhe kur nuk ka faj të individit për të thënë.

Përdorimi i humbjes së aftësive: Të papunët nuk janë në gjendje të vënë aftësitë e tij / saj për t'u përdorur. Dhe në një situatë ku vazhdon për një kohë të gjatë personi mund të duhet të humbasë disa nga aftësitë e tij / saj.

2.7 Ligji i Okunit

Kur vjen fjala tek ekonomia , zhvillimi dhe puna janë dy faktorë primar që ekonomistët duhet ti konsiderojnë / marrin parasysh. Ekziston një lidhje mes këtyre termeve dhe ekonomistë të shumtë e kanë studiuar lidhjen në mes të zhvillimit ekonomik dhe papunësisë. Ekonomisti i njohur Arthur Okun se pari ka filluar ta diskutojë këtë term me 1960, ai ka qenë një profesor dhe ekonomist mjaftë i njohur ku së pari ai ka fillur ti publikojë të dhënat e tij në fund të 1960-tës dhe hulumtimet e tij në lidhje me këtë temë janë bërë të njohura dhe që prej asaj kohe janë njohur si ligji i Okunit.

Në formën më bazike ligji Okunit investigon marrëdhënien të shkallës së papunësisë dhe zhvillimit ekonomik te një vendi. Ligji Okunit synon të na tregojë se sa shumë prodhimi i brendëshëm bruto, dmth GDP-ja mund të humbasë kur shkalla e papunësisë është mbi normën e saj natyrore. Logjika prapa ligjit Okun është e thjeshtë ; produkti varet nga sasia e punës që përdoret në procesin e prodhimit, kështu që ekziston një marrëdhënie pozitive midis prodhimit dhe punësimit. Punësimi gjithsej është i barabartë me fuqinë punëtore minus të papunët, kështu që ekziston një marrëdhënie negative mes prodhimit dhe papunësisë (e kushtëzuar nga forca e punës). "

Okun vuri në dukje se për shkak të rritjeve të vazhdueshme në madhësinë e forcës së punës dhe në nivelin e produktivitetit, Rritja reale e GDP-së pranë normës së rritjes së potencialit të saj zakonisht kërkohet, vetëm për të mbajtur qëndrueshmërinë e papunësisë. Për të reduktuar shkallën e papunësisë, ekonomia duhet të rritet me një ritëm mbi potencialin e tij.

Më konkretisht, sipas versioneve të pranuar të ligjit Okun, për të arritur një rënie prej 1 pikë përqindjeje në normën e papunësisë gjatë një viti, GDP-ja reale duhet të rritet përafërsisht 2 pikë përqindje më shpejt sesa norma e rritjes së GDP-së potenciale gjatë kësaj periudhe. Pra, për ilustrim, nëse shkalla e mundshme e rritjes së GDP-së është 2%, ligji Okun thotë se GDP-ja duhet të rritet me një normë prej 4% për një vit, për të arritur një reduktim prej 1 pikë përqindjeje në normën e papunësisë ".

Është e rëndësishme që të theksohet që lidhja midis papunësisë dhe zhvillimit/rritjes ekonomike është lidhje regresion. Si e tillë, kjo lidhje mund të rezultojë në diferencë të koeficientëve që përdoren për të zgjidhur ndryshimet në papunësinë duke u bazuar se si është rritur ekonomia. E gjitha varet në periudhën kohore të përdorur dhe nga inputet. Më poshtë është në shembull i ligjit të Okunit regresion.




Figura 2 Ligji i Okunit

(Ryan C, 2017)

Ligji me të vërtetë ka evoluar me kalimin e kohës për të përshtatur klimën e tanishme ekonomike dhe tendencat e punësimit. Një version i Ligjit të Okunit fokusohet në një marrëdhënie midis papunësisë dhe GDP-së, ku një përqindje e rritjes së papunësisë shkakton një rënie prej 2% të GDP-se. (UKEssays, 2017)

Në përgjithësi ligji Okun përfaqëson një nga metodat më të drejtpërdrejta dhe të përshtatshme për të hetuar marrëdhënien midis rritjes ekonomike dhe punësimit. Duke u mbështetur në të për të bërë parashikime specifike rreth papunësisë, duke pasur parasysh trendet e rritjes ekonomike, nuk funksionon dhe aq mirë.


Për shkak të kompleksitetit të inputeve, periudhat e ndryshme kohore që mund të përdoren dhe pasiguria bazë që shkon me regresione ekonomike të vazhdueshme, analiza mund të bëhet mjaft komplekse. Ligji i Okunit mund të mos jetë tërësisht parashikues, por mund të ndihmojë në diskutimin e rritjes ekonomike, mënyrën se si punësimi e prek atë dhe anasjelltas. (Guisinger and Sinclair, 2017)

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Për ta studiuar problemin e papunësisë, së pari duhet të dijmë së çfarë është papunësia. Në përgjithësi njerëzit termin papunësi e shpjegojnë si – njerëz që nuk kanë punë dmth të papunë. Mirëpo ky term është tejet më kompleks sesa atë. Në bazë të rezolutes të International Labour Organization 1982, një person mund të quhet si i papunë nëse ai apo ajo është i gatshëm për punë dhe është në kërkim të një pune. Pra me fjalë më të thjeshta papunësia është një fenomen që ndodh kur një person është i interesuar të punojë, mirëpo për shkak të zhvillimit të ngadaltë ekonomik si dhe vendeve të pakta të punës, ai apo ajo është i papunë

Por çfarë e shkakton papunësinë? Në grafën e mëposhtme janë të paraqitur faktorët që e shkaktojnë papunësinë.

Tabela 1 Faktorët që shkaktojnë papunësinë



Kërkesa e mangët për shkak të recesionit global, krizës financiare, normave të larta të interesit etj. Ana e ofertës ndryshimet teknologjike, paqendrueshmëria

gjeografike, papunësia friksionale dhe strukturore, papunësia për shkak të rrogave reale etj.

Papunësia vjen si rrjedhojë e shkaqeve të ndryshme, në përgjithësi janë 5 lloje/shkaqe të papunësisë:

- Papunësia Friksionale (Frictional Unemployment)- që i referohet periudhës në mes të ndryshimit të punëve. Njerëzit janë të papunë përderisa janë në kërkim të ndërrimit/gjetjes së një pune tjetër.
- Papunësia Ciklike (Cyclical Unemployment)- ndodh gjatë periudhës së recesionit. Gjatë kësaj periudhe kërkesa për të mira dhe shërbime bie. Kur kërkesa për punë është më e madhe sesa nevoja për punën, atëherë papunësia vijon.
- Papunësia Vullnetare (Voluntary Unemployment)- papunësia cilësohet si jovullnetare. Megjithatë ka raste kur njerëzit zgjedhin vullnetarisht që të mos punojnë.
- Papunësia Strukturore (Structural Unemployment)- ndodh kur aftësitë, edukimi, dhe eksperiencia e punëtorëve nuk përkon me kërkesat e punës.
- Papunësia Institucionale (Institutional Unemployment)- ndodh kur institucionet ndikojnë në papunësi. Shembull nëse qeveria vendos taksa, vendos cmime të larta dhe në mënyrë indirekte mbështet faktorët e tjerë për papunësi. (Modigliani, 1996)

Arsyet që njerëzit janë të papunë mund të jenë të ndryshme, disa ndër to mund të jenë : që dikush ka hequr dorë nga pozita e tyre në kërkim të një pune të re, kompania ka reduktuar numrin e fuqisë punëtore, disa janë pushuar nga puna, tek rastet tjera është numër i limituar për poziten që kane aplikuar etj.

Pra ekzistojnë teori të ndryshme të definimit të papunësisë, dhe kategorizimi tyre ndryshon se si njerëzit e shohin papunësinë. BLS (Bureau of Labor Statistics) e definojnë papunësinë , si njerëz që për momentin nuk kanë punë, por kanë kërkuar për një pozitë pune në 4javët e fundit dhe janë të gatshëm për punë. Ndërsa ata që nuk kanë kërkuar punë në 4javët e fundit nuk numërohen apo nuk hyjnë në listën e të papunësuarëve. BLS poashtu i shlyen ata nga forca punëtore. Edhe pse në fakt në grupin e forcës punëtore hyjnë personat që kanë përgjegjësi familjare, apo kanë ndonjë problem që i ndal ata nga puna. Por BLS e ka parë të arsyeshme që këta persona të i heq nga forca ata që nuk janë aktiv apo të interesuar. Dhe normalisht që BLS ka mbajtur shënime për këto statistika apo informacione, në mënyrë që ta dijë kush hyn dhe kush jo në forcën punëtore. Por jo cdokush mendon që BLS reprezenton atë se qka në të vërtetë është gjendje reale. Pasi që njerëzit që janë dorëzuar dhe mendojnë që nuk ka mbetur punë për ta BLS i quan punëtorë të dekurajuar, ama këta punëtorë sapo të përmirësohet niveli i punesimit ata shprehin interesim. Andaj ndodh një pabarazi. Ndërsa cili në të vërtetë është shkaku i papunësisë? Nga pikëpamja kombëtare , papunësia shkaktohet kur ka probleme të ndryshme që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Ndërsa këta faktorë të ndryshëm, ndikojnë në ngadalësim të zhvillimit ekonomik. Kur ndodh ky ngadalësim bizneset e ndryshme nuk kanë se si të i mbulojnë shpenzimet e ndryshme , andaj si mënyrë e lehtësimit apo reduktimit të këtyre shpenzimeve këto biznese, detyrohen të heqin nga puna disa punëtorë. Por jo domosdoshmërisht vetëm zhvillimi i ngadalë të ekonomik krijon papunësi. Faktorët tjerë të ndryshë janë që ndikojnë në papunësi dhe këta faktorë janë konkurrenca e lartë në treg dhe zhvillimi i avancuar teknologjik. Konkurrenca e lartë në treg, mund ta heq nga tregu apo të ia ulë suksesin/punën e cfarëdo kompanie, dhe ta shtyjë në fitim të ulët, andaj dhe krijohet papunësia. (Amadeo, 2017)

Ndryshimet sociale ndikojnë fuqishëm në strukturën dhe ambientin ekonomik. Andaj zhvillimi i shpejtë i urbanizmit po ndryshon kompozimin e punësimit. Pasiqë pritet që deri në vitin 2020 shumica e popullatës të jetojë në qytete urbane. Poashtu dhe zhvillimi i teknologjisë ndikon në mënyrën e punësimit. Dhe përshkak të këtyre ndryshimeve të shumëta strukturore një kualitet thelbësor është intelegjenca/njohuritë. Rëndësia e intelegjencës vë një theks të rëndësishëm në kualifikim dhe edukim. Dhe si pasojë e mungesës së këtyre njohurive, njerëzit përballen me vështirësi të shumëta për gjetjen e një pune në marketin e sotëm. (WDR, 2013)

Ofrimi dhe ndihmësa për ti ofruar punë rinisë mbetet një ndër top prioritet politike e secilit vend në botë. Poashtu mbetet si një ndër vështirësitë kryesore. Padyshim që papunësia e rinisë ndryshon nga një vend në tjetrin, për arsye që në disa vende mund të kenë nivele të aftësive të larta, por mundësi të pakëta punësimi ose e kundërta. Për shkak të krizës globale financiare ka pasur një ngritje të nivelit të të rinjëve të papunë dhe në pamundësi të rimëkëmbjes në disa vende ky problem është ende prezent. (Stefano, 2012)

Studimet kanë treguar që papunësia e tejkzgatur sjell vështirësi, probleme dhe humbje të shumëta të të ardhurave. Papunësia nuk është vetëm një vështirësi financiare, por papunësia sjell në vete dhe izolimin social, duke e bërë më të pakët kontaktin me të afërmit dhe shoqërinë. Ku si rrjedhojë e këtij izolimi mundësia për gjetje të një pune është më e pakët. Njerëzëve të papunë i duhet të përballen me probleme të shumëta të cilat i sjell papunësia. Këta njerëz kanë një sasi të limituar të parave që duhet ti shpenzojnë për nevojat bazike, siq janë ushqimi, jetesa, mbulimi i shpenzimeve të faturave mujore etj.

Pra vështirësitë të cilat i sjellë papunësia janë të shumëta. Janë vështirësi që fillojnë që nga nevojat bazike. Jo vetëm individët por dhe bizneset si tërësi përballen me këtë

problem. Do të thotë shoqëria si tërësi afektohet shumë nga papunësia e lartë. Gjatë periudhave të gjata dhe të vështira të papunësisë, njerëzit detyrohen që të marrin cdo punë që iu ofrohet. Edhe pse shumë të rinjë të diplomuar në fakultete të ndryshme, këta të rinjë detyrohen të kryejn punën në të cilën nuk janë të diplomuar. Mënyra se si shoqëria reagon kur mbesin të papunë, është e ndryshme. Ka nga ata që e përjetojnë shumë rëndë, dhe të jenë në shok për atë se çfarë ka ndodhur, dhe të humbin tërësisht shpresat që ndonjëherë do të mund të punësohen. (FRB,2018)

Pra në përgjithësi papunësia sjell stres, diskriminim në shoqeri, mërzi, ndjenja të turpër dhe poashtu probleme mendore. Këto karakteristika shfaqen tek ata që kanë kaluar një periudhë të gjatë kohore të papunë. Ndërsa tek rinia, këto ndjenja të papunësisë nuk janë dhe shumë të shprehura. Pasiqë të sapodiplomuarit kanë ende mbështetje nga familja si financiare ashtu dhe emocionale. Dhe të rinjët kalojnë kohën e tyre të shumtë duke u marr me aktivitete të ndryshme me shoqërinë. Andaj marrëdhënia në mes të papuëve dhe mbështetja sociale është komplekse. (Christian dhe Marco, 2016) dhe (Health Economis, 1997)

4. METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të prezantojë mënyrën e përdorur në këtë studim ndaj arritjes së objektivave të studimit dhe mbledhjes së të dhënave. Për të arritur këtë synim të punimit, materiale të ndryshme janë përdorur gjatë hulumtimit dhe janë përshtatur në bazë të nevojave për kompletimin e kësaj teme të diplomës.

Duke u bazuar në rëndësinë si dhe pa mundësinë në kapjen apo qasjen e të dhënave, është përdorur metoda kualitative, ajo kuantitative si dhe qasja hulumtuese. Për të kompletuar të gjitha të dhënat e nevojshme gjatë hulumtimit nuk është dhe aq e lehtë. Janë disa lloje të metodave kualitative të hulumtimit, ku tek këto të dhëna bëjnë pjesë: pyetësi, eksperimentet, historia, rastet e studimit dhe analiza e arkivit. Pas shqyrtimit të zgjedhjes të metodës më të përshtatshme, zgjedhja për këtë punim ka qenë analiza e arkivit si dhe historia nëpër librat ndryshëm përgjatë historikut të ekonomisë botërore. Janë marrë parasysh të dhëna kryesore dhe të ndryshme që kanë bërë të mundur zgjedhjen dhe lehtësimin e kuptimit të termave për këtë punim diplome.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Vendet e Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia- patën një rritje të fortë dhe reduktim të varfërisë që nga fillimi i tranzicionit drejt tregut ekonomik. Duke filluar nga një nivel i ulët, standardet e jetesës u rritën pothuajse gjashtëfish në Bosnje dhe Hercegovinë, gati u trefishuan në Shqipëri dhe pothuajse u dyfishuan në Serbi përgjatë periudhës kohore 1995 dhe 2015. Me 5% rritje ekonomike që përjetuan këto shtete të Ballkanit, patën një mesatare të përmirësimit të standardit jetësor me të shpejtë sesa shtetet tjera të BE-se. Gjatë kësaj periudhe, krijimi i vendeve të punës ndihmoi në uljen e normave strukturore të papunësisë dhe zbutjen e varfërisë në shumicën e vendeve të rajonit. Në fillim të viteve 2000, afërsisht një në tre persona në rajon jetonte në më pak se 5 dollarë për ditë. Deri në vitin 2008, kjo shifër kishte rënë vetëm një në pesë. Zhvillime të tjera që reflektonin zhvillimin e këtyre vendeve ishin jetëgjatësia, shkrim-leximi, dhe qasja në shërbime që gjithashtu u përmirësua gjatë kësaj periudhe.

Sidoqoftë, pavarësisht këtij progresi, këto gjashte shtete që përbëjnë Ballkanin Perëndimor mbeten në mesin e vendeve më të varfëra në Evropë. Tregjet e aksioneve ekzistojnë në katër prej gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dmth me përjashtim të Kosovës dhe Shqipërisë. Tregjet e kapitalit tek këto vende mbeten të pazhvilluara dhe me një numër të limituar të kompanive. Pra në përgjithësi tek këto vende të Ballkanit pjesëmarrja e investitorëve është shumë e kufizuar.

5.1 Niveli i zhvillimit tek shtetet Ballkanike

Trendet e zhvillimit të shteteve fqinje janë të paraqitura në tabelën më poshtë. Ku siq shihet Maqedonia është vendi që ka zhvillimin më të hovshëm ekonomik deri në vitin 2013 ku pastaj në atë vit Serbia kryeson me zhvillim. Gjendja e zhvillimit të Malit të Zi qysh nga viti 2008 dhe deri tek viti 2013 nuk ka asnjë përmirësim apo dhe ndryshim në gjendjen e zhvillimit ekonomik. Shqipëria është ajo që vit pas viti qdo herë e ngapak ka pasur zhvillim gjithmonë e në ngritje poashtu dhe Serbia.




Figura 3 Trendet dhe Zhvillimet nder vite tek shtetet fqinje

Kosova ka një kapacitet shumë të ulët të zhvillimit ekonomik. Padyshim që lufta ka ndikuar në gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën jemi pasiqë niveli i lartë i papunësisë, jo industrializimi dhe deficiti i tregut, të gjitha këto janë pasoja të viteve të luftës.

Megjithatë viteve të fundit shteti ynë Kosova ka pasur pak progres në anën ekonomike. Nevojat e konsumtorit kryesisht plotësohen nga importet e shumëta që ka vendi ynë, pasiqë dhe niveli i prodhimit është tepër i ulët. Partnerët e Kosovës në

eksport dhe import janë : Italia, Shqipëria, Maqedonia, Zvicra, Gjermania , Kina dhe Serbia.

Kosova dhe Shqipëria kanë karakteristika të shumëta të përbashkëta jo vetëm nga ana historike dhe kulturore por edhe nga ana e zhvillimit ekonomik. Qe te dy shtetet pas shpalljeve te Pavaresise , 1912 dhe 2008 kanë pasur një rritje në fluksin tregtar.

Megjithate edhe pse Shqipëria ka një nivel te zhvillimit ekonomik me te mire se Kosova , edhe ajo si Kosova ka një nivel të ulët të zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe nivel të ulët të prodhimitarisë.

Për shtetet e vogla sikur Kosova dhe Shqipëria krahasuar me shtetet fqinje , ndikim tejet pozitiv do te kishe promovimi i eksportit gjë që do të ndikonte në krijim të vendeve të punës dhe njëkohësisht në zhvillim ekonomik.

Tabela 2 Te dhenat e eksporteve dhe importeve ne neto/kg

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Eksporti Neto Kg	136,351,193.65	267,876,692.07	124,714,723.48	154,134,739.44	167,140,338.35	181,641,927.97	165,289,802.52
Eksporti Vlera	19,387,328.35	24,854,817.00	30,839,288.21	37,717,130.19	59,391,271.16	56,435,798.81	29,797,599.28
Importi Neto Kg	132,627,902.91	125,193,634.26	251,636,065.85	466,048,842.55	715,216,174.26	684,889,834.69	687,119,803.33
Importi Vlera	52,751,749.86	39,924,194.72	61,600,951.66	91,588,280.67	105,093,129.54	106,878,594.08	125,485,312.65

Burimi: (Hollaj, L. 2015)

Pra siq e shohim tek figura e mësipërme është e paraqitur tabela me të dhenat e eksporteve dhe importeve të Kosovës të shprehura në vlerë dhe neto/kg. Që nga viti 2008 dhe deri tek viti 2014 në të dhënat e eksporteve nga Kosova drejt Shqipërisë kryesisht dominojnë metalet. Në vitin 2008, vlera totale e eksporteve në Neto Kg ishte 136,3 milion

kg e cila arriti në 165,2 milion kg në fund të vitit 2014. Dmth vërehet një rritje prej 21.22% në nivelin e përgjithshëm të eksporteve në mes të dy vendeve. Ndërsa duke i krahasur në vlerë ekonomike i bie që në vitin 2014 të jetë 29,8 milion EUR, ndërsa në vitin 2008 19,3 milion EUR. Nga viti 2008, vlera e eksporteve të Kosovës drejt Shqipërisë është dyfishuar ku ndikim të madh ka pasur dhe ndërtimi i autostradës Durrës-Kukës-Morinë.




Figura 4 Eksporti, importi dhe bilanci tregtar i Kosoves me Shqiperine 2008-2014

Burimi: (Hollaj, L. 2015)

Tek grafi i misipërm vërehet që niveli i importeve nga Kosova në Shqipëri ka një rritje të dukshme. Niveli i importeve në vitin 2008 ishte 59,6 milion euro ndërsa në vitin 2014 niveli i importeve është shumëfishuar duke arritur vlerën prej 133,7 milion euro. Importet kanë pasur një rritje prej 124% ndërsa eksportet 108% , këto të dhëna janë në përputhje me nivelin e prodhimit që këto dy shtete kanë dhe rezulton një rritje paralele e dy vendeve.

Kosova krahasuar me shtete fqinje sa i përket resurseve nuk ka mungesë të tyre .Historikisht Kosova është e lidhur ngushtë me Maqedoninë dhe Serbinë për nga ana e tregtisë ndërsa në të kundërt Shqipëria ka marrëdhënie tregtare të ngushta me Greqinë

dhe Italinë. Si strategji për përmirësimin e marrëdhënieve për zhvillim ekonomik të tregtisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është menduar të jenë këto:

- Fuqizimi i marrëveshjeve bilaterale dhe jetësimi tyre
- Themelimi i komisionit për identifikim të diskrepancave ligjore
- Themelimi i një administrate për monitorim të progresit dhe monitorimit të barrierave tregtare .

5.2 Sfida e zhvillimit -problemi

Sfida për një zhvillim dhe integrim ekonomik ende vazhdon. Përgjegjësia për këtë moszhvillim qëndron tek qeveria dhe standardet apo rregullat e vendosjes së fiskalitetit për të lehtësuar dhe mundësuar investimet. Duke përmirësuar drejtësinë, dhe duke mos përfshirë mosmarrëveshjet ndërkufitare, këto shtete rajonale mund të hapnin më shumë regjione tregtisë, të përmirësojë diversifikimin e financave dhe nxitjen e konvergencës ekonomike. Pra përmes koordinimit, bashkëpunimit koherent, është e mundur të përmirësohet klima e biznesit për të gjithë rajonin, të përmirësohet besimi në qeveri dhe të rritet mundësia e rritjes ekonomike.(Hollaj, 2015)

Siq është cekur dhe në paragrafët më lartë shkalla e papunësisë është raporti midis numrit të të papunëve dhe atyre të punësuar dmth forcës punëtore. Tek vendet e Ballkanit Perëndimor rinia e arsimuar po largohet nga këto vende dhe kërkon të jetojë dhe punojë në vendet e zhvilluara të BE-së, në SHBA dhe Kanada. Rajoni më i varfër i Europës, konsiderohet Ballkani Perëndimor/ Në raportin e Grupit të Bankës Botërore dhe Institutit

të Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, theksohet se tregjet e punës në të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen me nivel të ulët të punësimit dhe me niveli të lartë të papunësisë në krahasim me standartet e Bashkimit Europian. Me nivel më të lartë të papunësisë është Bosnjë-Herzegovina me 57,5%, më pas Maqedonia me 50,8%, Serbia me 49,5 %, Shqipëria me 26.4% dhe Kosova me mbi 50%. Në këto kushte të papunësisë rinia e Ballkanit Perëndimor po largohet nga rajoni, gjë që ka pasoja të rënda në përpjekjet e vendeve të rajonit për të përshpejtuar ritmet e zhvillimit ekonomik dhe afrimin me Bashkimin Europian. *(Pranvera,2017)*

6. DISKUTIME DHE KONKLUZIONE

Në paragrafët e mësipërm janë dhënë definicione të shumëta të papunësisë, pasi që është një term që është studiuar nga ekonomist të shumtë dhe secili nga ta ka dhënë një përkufizim në mënyrën e vet. Papunesia është kur kërkesa dhe oferta për punë nuk takohen në një pikë të përbashkët, apo ndryshe quajtur ekuilibrium. Mirëpo mund të themi që termi më i thjeshtë për papunësinë mund të jetë ; papunësia është numri i njerëzve në fuqinë punëtore që duan të punojnë mirëpo nuk e kanë një punë.

Shkalla e papunësisë është indikator me të cilin matet se si po shkon ekonomia. Andaj Bureau of Labor Statistics (BLS) është një agjenci në Washington DC që mbledh të dhëna nëpërmjet anketimeve të ndryshme për të mësuar se kush bën pjesë në fuqinë punëtore dhe kush jo. Këto të dhëna anketohen nga njerëz të moshës 16 vjeçare dhe më të vjetër, të cilët nuk janë në burg dhe nuk bëjnë pjesë në forcat e armatosura. Këto anketime bëhen çdo muaj. Nëse keni një punë atëherë BLS iu fut në listën si të punësuar; nëse thoni që nuk keni një punë mirëpo keni qenë aktiv/ në kërkim për punë atëherë jeni në listën si i papunësuar; por nëse thoni që nuk keni një punë dhe nuk jeni interesuar për një punë përgjatë muajit atëherë nuk bëni pjesë në forcën punëtore. Por këta njerëz që nuk bëjnë pjesë në forcën punëtore çfarë bëjnë ata? Shumica e tyre janë në pension, disa janë në shkollë ose në programe të ndryshme trajnimi por disa prej tyre që kanë qenë të interesuar për punë janë lodhur dhe nuk kanë vazhduar së kerkuari për punë, BLS këta njerëz i fut në listën e punëtorëve të diskurajuar.

Studimet kanë treguar që papunesia e tejzgjatur sjell veshtiresi, probleme dhe humbje të shumta të ardhurave. Papunesia nuk është vetëm një veshtiresi financiare, por papunesia sjell në vete dhe izolimin social, duke e bërë me ta pak kontaktin me të

afermit dhe shoqerine. Ku si rrjedhoje e ketij izolimi mundesia per gjetje te nje pune eshte me e paket. Njerezit e papune duhet te perballen me probleme te shumeta te cilat i sjell papunesia. Keta njerez kane nje sasi te limituar te parave qe duhet ti shpenzojne per nevojat bazike, siq jane ushqimi, jetesa, mbulimi i shpenzimeve te faturave mujore etj. Pra veshtiresite te cilat i sjelle papunesia jane te shumeta. Jane veshtiresi qe fillojn qe nga nevojat bazike

Ndërsa zhvillimi ekonomik është rritja e nivelit të jetesës të njerëzve të një vendi nga të ardhurat e pakëta në të ardhura më të larta. Do të thotë kur kualiteti i jetesës përmirësohet atëherë ka më shumë zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik përmirëson gjendjen ekonomike, politike dhe sociale të shoqërisë. Është mjete me i rëndësishem për ta zvogeluar varferine dhe për të përmirësuar kualitetin e jetesës është rritja ekonomike. Rritja gjeneron prosperitet dhe mundësi të shumeta. Rritja e fortë dhe stabile ndikon në përmirësim të kushteve që prinderit ua ofrojnë fëmijëve për një jetë dhe shkollim sa më të mirë. Zhvillimi ekonomik qon drejt përparimit të njerëzimit, me të cilin promovohet rritja ekonomike.

GDP përdoret për të krahasuar madhësinë e ekonomisë me vendet tjera gjithashtu mund të përdoret për të krahasuar ritmin e rritjes së ekonomive në vendet e ndryshme.

Pra zhvillimi ekonomik do të thotë rritje absolute në madhësinë e kapitalit apo prodhimit vjetor pavarësisht madhësisë së popullatës. Kuptimet janë të shumeta, mund të nënkuptojë rritje në kompleksitet, ose dhe progres drejt arritjes së një qëllimi të caktuar. Në përgjithësi investimi i referohet të gjithë aktiviteteve ekonomike që përfshijnë përdorimin e resurseve për prodhim të mirave dhe shërbimeve. Të gjitha modelet e

rritjes apo zhvillimit ekonomik fokusohen tek kapitali si nje nga dy parametrat kryesor ne percaktimin e shkalles se zhvillimit ekonomik.

Përkatësisht, nëse GDP-ja po bie çdo vit, do të shkaktojë dështime të biznesit dhe në këtë mënyrë do të rrisë papunësinë. Përveç kësaj, papunësia e lartë do të reduktojë të ardhurat kombëtare dhe efektin negativ në BPV për kapital dhe normën e inflacionit. Në ekonominë e sotme, secili shtet ka pësuar një krizë globale financiare, kështu që planifikuesit dhe parashikuesit ekonomik mund të mësojnë nga kriza e kaluar financiare për t'u bërë më të fortë dhe më shumë strategji për ta përballuar atë përsëri.

Shumica e ekspertëve janë pothuajse te mendimit te njejet që çelësi i rimëkëmbjes ekonomike apo zhvillimit ekonomik është ulja e nivelit të papunësisë. Mirepo ende nuk është ardhur ne perfundim te nje formule adekuate e cila mund te ule nivelin e papunesise dhe te rrise zhvillimin ekonomik . Edhe pse në të ardhmen nuk do e dime se kur do të përballemi përsëri me krizën financiare, por nje gje eshte e sigurte qe GDP-ja reale, dhe papunësia po luajnë një rol të rëndësishëm në krizën financiare.

7. REFERENCAT

1. IDOSI Publications (2012) " *The relationship between Unemployment and Economic Growth*". Retrived from [https://pdfs.semanticscholar.org/95c3/7e58c6b350dd0eb30e7bfdeb53d6c524564a.pdf3]
2. E.Hall R .(July, 1978), " *A theory of the natural unemployment rate and the duration of employment*". Retrived from [http://www.nber.org/papers/w0251.pdf]
3. Desnoyers M. (February 20122), " *The relationship between economic growth and employment*". Retrived from https://www.disnat.com/en/learning/expert-articles/marc-desnoyers/the-relationship-between-economic-growth-and-employment
4. Economy Stats (April, 2018) "Unemployment its causes and its consequences". Retrived from [https://www.thebalance.com/what-is-unemployment-3306222]
5. WDR (2013), " *Jobs*". Retrived from [https://siteresources.worldbank.org/EXTNWDR2013/Resources/8258024-1320950747192/8260293-1322665883147/WDR_2013_Report.pdf]
6. " *Definition of Unemployment*" Retrived from [http://www.roundtablecommunity.org.hk/qef/mconf/mg20_topic_sg.pdf]
7. Federal Reserve Bank, " *Consequences Of Unemployment*" Retrived from [https://www.econlowdown.org/consequences_of_unemployment?module_uid=235§ion_uid=419&page_num=2826&p=yes]
8. Robbins L. " *The Theory Of Economic Development in the History of Economic Thought*" Retrived from : [https://mises.org/sites/default/files/The%20Theory%20of%20Economic%20Development_2.pdf]

9. Mehta P. "*Bad Effects of Unemployment on Economic Growth*" Retrieved from: [http://www.economicdiscussion.net/articles/bad-effects-of-unemployment-on-economic-growth/2285]
10. Shostak F , (September 2010) "*Is there a link between Unemployment and Economic Growth*". Retrieved from http://www.cobdencentre.org/2010/09/unemployment-and-economic-growth
11. Muhammad S. Anwer and R.K.Samphath "*Investment and Economic Growth*". Retrieved from : [https://ageconsearch.umn.edu/bitstream/35713/1/sp99an01.pdf]
12. DFID "*Growth- Building Jobs and Prosperity in Developing Countries*" Retrieved from : [http://www.oecd.org/derec/unitedkingdom/40700982.pdf]
13. Michael T. Owyang and Tara M.Sinclair , (October 2017) "*A state level analysis of Okun's Law*". Retrieved from : [https://files.stlouisfed.org/files/htdocs/wp/2015/2015-029.pdf]
14. *Economic Development Overview* Retrieved from: [https://www.nyu.edu/econ/user/debraj/Courses/GrDev14Warwick/Notes/RayCh2Update.pdf]
15. "*World Development*" Retrieved from : [https://newint.org/books/reference/world_development_chapter_1.pdf]
16. WIFO , Stefan M. "*How strong is the correlation between unemployment and growth really?*" Retrieved from: [http://www.foreurope.eu/fileadmin/documents/pdf/PolicyPapers/WWWforEurope_Policy_Paper_023.pdf]
17. "*The effects of Unemployment On Society and Economy*" Retrieved from : [http://www.job-interview-site.com/the-effects-of-unemployment-on-society-and-the-economy.html]

18. Andrei D, Vasile D, Adrian E : "The correlation between Unemployment and real growth"
Retrieved from : [<https://core.ac.uk/download/pdf/6304085.pdf>]
19. Soubbotina. T "*Beyond Economic Growth*". Retrieved from :
[<http://gen.lib.rus.ec/book/index.php?md5=500526BF61CB36300F8850776730512E>]
20. J.Barro R. "*Economic Growth*". Retrieved from:
[<http://gen.lib.rus.ec/book/index.php?md5=072FCC5FF875C94D1C5E58A4AF99631C>]
21. Hollaj, L (2015) "*Marredheniet Tregtare Kosove- Shqiperi : Ku jemi dhe si vazhdojme me tutje?*". Retrieved from : [http://indep.info/wp-content/uploads/2015/01/14039_INDEP-2015_MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-TREGTARE-KOSOV%C3%8B-%E2%80%93SHQIP%C3%8BRI.pdf]
22. Zogaj A, (2009) "*Sfidat e Kosoves per qendrueshmeri ekonomike*". Retrieved from: [https://aab-edu.net/downloads/01_2009_03___muh_3u5u9.pdf]
23. Ballkani Perëndimor , (2017). Retrieved from :
[<http://pubdocs.worldbank.org/en/425051491490470862/WBRER-11-ALB.pdf>]